



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
Këshilli Drejtues

V E N D I M

Nr.2647, datë 03 .12. 2015

për

“Miratimin e zonave me densitet të ulët të popullsisë për mbulimin me shërbime broadband dhe zonave për përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar për sipërmarrësin Vodafone Albania sh.a.”

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 03.12.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr. 2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

Miratimin e zonave me densitet të ulët të popullsisë për mbulimin me shërbime broadband dhe zonave per përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar.

BAZA LIGJORE:

1. Neni 7, neni 25 dhe neni 102 të ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji Nr. 9918**);
2. Pika 5 e Vendimit Nr. 300, datë 08.04.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.468, datë 30.5.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për Miratimin e Planit Kombëtar për Zhvillimin e Broadband-it”,

3. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP Nr.2566, datë 11.05.2015 “Për dhënien e Autorizimit Individual sipërmarrësit “Vodafone Albania” sh.a. për përdorimin e frekuencave të brezit 900 dhe 1800 MHz”,
4. Rregullore Nr. 16, datë 16.04.2010 “Për Treguesit e Cilësisë së Shërbimit”, e ndryshuar me VKD Nr.2230, datë 28.12.2012.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor mbi çështjen, paraqitur nga grupi i punës si më poshtë:

- Dokumenti “Zonat me densitet të ulët të popullsisë për mbulimin me shërbime broadband dhe zonat për përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar”;
- Relacioni mbi projekt-aktin;
- Dokumentacioni bashkëshoqërues:
 - “Marreveshja kuader bashkepunimi”, datë 05.11.2015 midis Vodafone Albania sh.a., Telekom Albania sh.a. dhe Albtelecom sha. depozituar ne AKEP me Nr.2056 Prot., datë 18.11.2015, me tabelat përkatëse të zonave me densitet të ulët të popullsisë për mbulimin me shërbime broadband dhe zonave për përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar.
- Projekt-vendim i Këshillit Drejtues; si dhe,
- Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen,

duke arsyetuar në mbështetje të bazës ligjore referuese,

V Ë R E N s e :

1. Vendimi Nr. 300, datë 08.04.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.468, datë 30.5.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për Miratimin e Planit Kombëtar për Zhvillimin e Broadband-it” nxit mbajtësit e autorizimeve të frekuencave të brezit 900/1800 MHz dhe 2100 MHz, sipas një akti të nxjerrë nga AKEP-i, që të rritin mbulimin me shërbime broadband në zonat me densitet të ulët të popullsisë si dhe të përmirësojnë cilësinë e shërbimit të ofruar.
2. AKEP pas procesit të këshillimit publik dhe asistencës së dhënë nga Banka Botërore për Shërbimin Universal në Shqipëri, me Vendimin Nr.2324, datë 28.06.2013, miratoi dokumentin: “Statusi Aktual dhe Plani Kuadër 2013-2016 për Shërbimin Universal në Shqipëri”. Në bazë të studimit të kryer dhe pikës 3 të Planit Kuadër për vitet 2013-2016 për Shërbimin Universal në fushën e komunikimeve elektronike:

- AKEP duhet të koordinojë/inkurajojë një ose disa operatorë të ofrojnë akses në vendndodhje specifike gjeografike ku nuk ka mbulim me sinjal telefonik, jashtë skemës së SHU.
 - Këto masa (vendimi dokumenti që do miratohet) përveç rritjes së cilësisë së shërbimeve me akses broadband synojnë rritjen e mbulimit me sinjal telefonik duke kontribuar në këtë mënyrë në shërbimin universal në territorin e R.SH..
3. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP Nr.2566, datë 11.05.2015 “Për dhënien e Autorizimit Individual sipërmarrësit “Vodafone Albania” sh.a. për përdorimin e frekuencave të brezit 900 dhe 1800 MHz” vendosi disa kushte lidhur me mbulimin me shërbim për disa zona të vecanta, si dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit në zona ku ai ofrohet nën parametrat e performancës së përcaktuar në aktet rregullatore të AKEP.
 4. Në zbatim të vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP-it Nr.2566, datë 11.05.2015 dhe Rregullores Nr. 16, datë 16.04.2010 “Për Treguesit e Cilësisë së Shërbimit”, e ndryshuar me VKD Nr.2230, datë 28.12.2012, AKEP realizoi një proces konsultimi me operatorët Vodafone, Telekom Albania dhe Albtelecom për caktimin e zonave me densitet të ulët të popullsisë për mbulimin me shërbime broadband dhe zonave për përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar si dhe propozimet lidhur me planet e investimeve të përbashkëta të parashikuara në këto zona.
 5. Është depozituar në AKEP Marrëveshja kuadër bashkëpunimi date 5.11.2015 midis Vodafone Albania sh.a., Telekom Albania sh.a. dhe Albtelecom sha. me tabelat përkatëse për investime në zonat me densitet të ulët të popullsisë për mbulimin me shërbime broadband dhe zonave për përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar.
 6. Drejtoria e Administrimit të Burimeve të Fundme, Autorizimeve dhe Faciliteteve dhe Drejtoria e Monitorimit të Frekuencave, Cilësisë dhe Inspektimit paraqet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e Këshillit Drejtues dokumentin “Zonat me densitet të ulët të popullsisë për mbulimin me shërbime broadband dhe zonat për përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar”.
 7. Praktika dokumentare për shqyrtim të çështjes sipas objektit është paraqitur nga grupi i punës në përputhje me kërkesat proceduriale të përcaktuara në nenin 12 të Rregullores së Brendshme të AKEP.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 1 të nenit 114 dhe nenit 115 të ligjit Nr. 9918:

V E N D O S I:

1. Miratimin e dokumentit “Zonat me densitet të ulët të popullsisë per mbulimin me shërbime broadband dhe zonat për përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar” për sipërmarrësin Vodafone Albania sh.a. sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi;
2. Ngarkohen strukturat e AKEP për ndjekjen e zbatimit të detyrimeve të Sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a, sipas Dokumentit bashkëngjitur në vijimësi gjatë vitit 2016.
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____
2. **Anila DENAJ** _____
3. **Ketrin TOPÇIU** _____
4. **Klarina ALLUSHI** _____